

Bastisjet në Zveçan e Zubin Potok: Shtatë të arrestuar për rastin e vrasjes së zyrtarit të EULEX-it



19/10/2025 15:11



Bastisjet e sotme në Zubin Potok dhe Zveçan nga Prokuroria Speciale në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, u kryen në kuadër të një hetimi lidhur me vrasjen e zyrtarit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) A.S., me qëllim të verifikimit të informatave dhe identifikimit të mundshëm të provave relevante.

Gjatë operacionit, janë shoqëruar në Polici shtatë persona, dhe pas intervistimit janë liru

Sipas njoftimit të Prokurorisë, hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, kanë kryer bastisje në dy lokacione në Zveçan dhe në shtatë lokacione në Zubin Potok, nën dyshimin për kryerjen e veprave penale:

– Rrezikimin e personelit të Kombeve të Bashkuara ose personelit në marrëdhënie me to;

– Vrasje të Rëndë;

– Sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

“Ndërsa, gjatë zbatimit të urdhrit për bastisje, si një hap i rëndësishëm procedural në kuadër të një hetimi që është ende në zhvillim, janë gjetur dhe sekuestruar prova materiale sikurse: dy armë, municion, veshje me përmbajtje nacionaliste, dylibi, dokumente, pajisje elektronike të ndryshme etj. Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës, rihesojnë përkushtimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe sjelljen para drejtësisë të atyre që çenojnë sigurinë, ligjin dhe rendin në Republikën e Kosovës”, thuhet tutje në njoftim.



Artikuj të ngjashëm



October 19, 2025
Arbër Ademi: AKI i vlerëson zgjedhjet demokratike, me disa lëshime



October 19, 2025
Hoxhaj: Politika e jashtme e Kosovës është e humbur në botën e re



October 19, 2025
Gjykata: I dyshuari për plagosjen në Pejë kishte planifikuar arratisjen duke...



October 19, 2025
Pas mbylljes së vendotimeve, VLEN-i pret fitore pa balotazh në Çair,...



October 19, 2025
Ramadani: Nuk ka shumicë parlamentare, mund të ketë zgjedhje parlamentare më...



October 19, 2025
Zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut, të gjitha vendvotimet mbyllen me kohë



Other Links